

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Qubitzz” SH.P.K**

Sot, më datë 19/042018, unë i nënshkruari:

**Z. Arbër Kaci**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 09/05/1989, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, i identifikuar me pasaportë Nr. BG1326504 dhe me aftësi të plotë juridike për të vepruar,

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, kam vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“Qubitzz” SH.P.K** (më poshtë referuar si *“Shoqëria”*), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse dhe i bashkangjitet këtij Akti Themelimi.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë do të jetë **“Qubitzz” SH.P.K**

**Neni 2**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Gjon Muzaka”, njësia bashkiake Nr. 10, pallati 125, zyra Nr. 3, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të vendit, gjatë aktivitetit të saj.

**Neni 3**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar në kohë, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

**Neni 4**

Objekti i Shoqërisë është si vijon:

- Agjensi publicitare, programim, konsulencë, marketing.

**Neni 5**

Kapitali fillestar i Shoqërisë është 100 lekë dhe i ndarë në kuota me të njëjtën vlerë por asnjëherë më e vogël se 1 lekë. Kuotat që janë më të mëdha se 1 lekë i japin të drejtën e një vote për çdo 1 lekë.

Kapitali zotërohet 100% nga ortaku i shoqërisë si më poshtë vijon:

**Z. Arbër Kaci**, i cili do të zotërojë 100 kuota të kapitalit të Shoqërisë, ose 100 lekë (ALL) që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Ortaku mund të vendos të rris kapitalin e Shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Detyrimet e ortakut kundrejtë Shoqërisë do të mbulohen vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tij. Ortaku nuk do të ketë asnjë përgjegjësi tjetër për detyrime të tjera të Shoqërisë.

#### **Neni 6**

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetes të drejta dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore.

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhtme:

- Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë
- Administratori

Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve, si dhe të Administratorit të Shoqërisë janë të parashikuara në statutin e Shoqërisë.

#### **Neni 7**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët, e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga Administratorët e Shoqërisë.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **Neni 9**

Në rast se Shoqëria do të mbyll aktivitetin e saj për çdo lloj arsye, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë, përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidatorë dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për ç' regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

#### **Neni 10**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e Shoqërisë i besohet një ekspertit ose revizori kontabël. Ky ekspert do të emërohet dhe qëndrojë në detyrë sipas parashikimeve që bën ligji për ekspertët dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta ligjore.

## Neni 11

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të çështjeve të mësipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do ti kalojnë ortakëve të Shoqërisë.


## Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përsa është shprehur në këtë Akt Themelimi, i referohemi ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Qubitzz" SH.P.K.

  
Z. ARBËR KACI